



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-klina.org](http://www.komuna-klina.org)

## KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

### RREGULLORE PËR KUSHTET DHE MËNYRËN E BLOKIMIT DHE ZHVENDOSJES SE AUTOMJETEVE

Klinë, korrik 2018

Në mbështetje të nenit 12.2 pika C dhe nenit 17 pika f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-40 publikuar ne gazetën zyrtare, nr.28/2008, nenit 2.9 të Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin rrugor, Nr.02/L-70 dhe nenit 94, 95, 96 dhe 97 te Ligjit per Rregullat e Trafikut Rrugor, Nr.05/L-088, si dhe nenit 10 pika 3 të Statutit të Komunës se Klinës te vitit 2010, Kuvendi i Komunës së Klinës, në mbledhjen e rregullt te mbajtur më 31.07.2018, miratoi, këtë:

## **RREGULLORE**

### **PËR KUSHTET DHE MËNYRËN E BLOKIMIT DHE ZHVENDOSJES SE AUTOMJETEVE**

#### **Neni 1**

##### **Dispozitat e Përgjithshme**

Më këtë Rregullore përcaktohen kompetencat dhe kushtet për mbikëqyrje përkatësisht mënyra e bllokimit dhe zhvendosjes se automjeteve të ndaluara dhe te parkuara në kundërshtim më rregullat e komunikacionit në territorin e Komunës së Klinës.

#### **Neni 2**

Mbikëqyrjen në kuptim të nenit paraprak e bën Policia e Kosovës përmes të njësitit të nivelit lokal, atij regjional dhe njësitet e tjera kompetente për mbarëvajtjen e komunikacionit si dhe Inspektori I komunikacionit I Komunës së Klinës.

#### **Neni 3**

Blokimin apo zhvendosjen e automjeteve të ndaluara dhe te parkuara në kundërshtim me rregullat e komunikacionit e bënë subjekti afarist personi juridik apo fizik i përzgjedhur nga Komuna mbi bazën e procedurave të prokurimit, në tekstin e mëtejme operatori.

#### **Neni 4**

##### **Kushtet për ushtrimin e veprimtarisë për bllokim dhe zhvendosje të automjeteve**

1. Për ushtrimin e veprimtarisë për bllokimin apo zhvendosjen e automjeteve operatori është i obliguar të plotësojë kushtet e përgjithshme dhe atë:

1.1. Dëshmia e regjistrimit dhe licencimit;

- 1.2. Dëshmia e pronësisë së paku 2 (dy) automjeteve të destinuara për transport të automjeteve "Merimangë", që mundë të transportojë automjete deri në masë 2.500 kg;
- 1.3. Dëshmia e pronësisë apo qiramarrjes të zyrave dhe lokacionit të përshtatshëm për transferim dhe ruajtje të automjeteve;
- 1.4. Sigurimi i shërbimit 24 orë në ditë në javë si dhe rojën me kujdestari për pranim, ruajtje dhe dorëzim të automjeteve;
- 1.5. Posedimi i së paku dhjetë bllokuesve të rrotave më ngjyrë të verdhë;
- 1.6. Aparatin digjital për fotografim të automjetit në vendin në të cilin bllokohet apo vendi nga i cili zhvendoset;
- 1.7. Sistemin funksional të radiolidhjes, dhe
- 1.8. Numër të mjaftueshëm të personelit.

#### **Neni 5**

1. Automjetet për ushtrimin e veprimtarisë në kuptim të kësaj rregulloreje, duhet t'i plotësojnë kushtet dhe atë të jenë:

- 1.1. Të regjistruara;
- 1.2. Të destinuara për transport të automjeteve;
- 1.3. Në gjendje të rregullt teknike;
- 1.4. Të ketë pajisje të parapara për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse;
- 1.5. Të kenë dritën rrotulluese me ngjyrë të verdhë të vendosur mbi automjet, dhe;
- 1.6. Të ketë shenjat identifikuese për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse.

#### **Neni 6**

**Kushtet dhe mënyra e bllokimit dhe zhvendosjes së automjeteve.**

1. Mbi bazën e konstatimit për ndalim apo parkim të automjetit në kundërshtim me rregullat e komunikacionit, zyrtarët e autorizuar sipas nenit 2 të kësaj rregulloreje, japin urdhëresë në formë të shkruar për bllokim apo zhvendosje të automjetit përkatës.
2. Automjetet në kuptim të paragrafit paraparak konsiderohen mjetet të cilat i bashkëngjiten automjetet për të cilat i bashkëngjiten automjetet përkatësisht rimorkiot dhe makinat e punës.

#### **Neni 7**

1. Urdhëresa për bllokim apo zhvendosje të automjetit përmban:

- 1.1. Nr. i urdhëresës;
- 1.2. Datën;
- 1.3. Kohën;

- 1.4. Emërtimin e rrugës;
- 1.5. Markën e automjetit dhe numrin e targave;
- 1.6. Përshkrimin i kundërvajtjes;
- 1.7. Konstatimin për bllokim apo zhvendosje të automjetit;
- 1.8. Të dhënat e urdhërdhënësit.

#### **Neni 8**

Personi zyrtar pas konstatimit të kundërvajtjes, përmes radiolidhjes apo telefonit-celular, e informon operatorin I cili në afatin sa më të shkurtë shkon në vendin e ngjarjes dhe ndërmarr veprimet për bllokim apo zhvendosje të automjetit përkatës.

#### **Neni 9**

1. Operatori, në vendin e ngjarjes, është i obliguar të:
  - 1.1. Merr urdhëresën në formë të shkruar për bllokim apo zhvendosje të automjetit;
  - 1.2. Fotografoji automjetin;
  - 1.3. Kontrollojë për dëmtime të mundshme dhe në rast të dëmtimeve të njëjtat fotografohen në mënyrë të qartë;
  - 1.4. Të evidentojë të gjitha të dhënat sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje;
  - 1.5. Të përpilojë procesverbalin më të dhënat sipas këtij neni dhe të dhënat tjera eventuale si dhe procesverbalin ta nënshkruaj nga Urdhërdhënësi dhe personi I cili e benë bllokimin apo zhvendosjen e automjetit.

#### **Neni 10**

1. Në rastet e bllokimit të automjetit, operatori është i obliguar që në xhamin e përparmë të automjetit të vendosë etiketën me udhëzim se çfarë duhet të bëjë vozitësi për de bllokimin e automjetit.
2. Teksti i etiketës shtypet në gjuhët zyrtare të komunës.

#### **Neni 11**

1. Procedura për bllokim apo zhvendosje të automjetit konsiderohet e filluar kur operatori e merr urdhëresën (përmes radiolidhjes apo telefonit-celularit) për të shkruar në vendin e ngjarjes.
2. Pronari apo shfrytëzuesi I automjetit të bllokuar nëse në afatin prej 24 orëve nuk kërkon deblokimin, automjeti zhvendoset në lokacionin e operatorit.
3. Në rastet nga paragrafi paraprak llogariten shpenzimet përkatëse për bllokim dhe zhvendosje.

### Neni 12

1. Shpenzimet për deblokim apo zhvendosje i bartë pronari apo përkatësisht shfrytëzuesi i automjetit.
2. Cilësia e shfrytëzuesit të automjetit dëshmohet përmes autorizimit valid.

### Neni 13

Operatori është i obliguar që automjetet e transferuara në lokacionin përkatës ti ruaji deri në dorëzim pronarit apo shfrytëzuesit të automjetit.

### Neni 14

Dëmet në automjete të shkarkuara me rastin e bllokimit, zhvendosjes apo gjatë qëndrimit në lokacionin e automjeteve i bartë operatori.

### Neni 15

1. Kundër urdhëresës për bllokim apo zhvendosje të automjetit nuk është e lejuar ankesa, por çështja është e ndërlidhur me ankesën në procedure për kundërvajtjen përkatëse.
2. Ankesa nuk e pezullon pagesën e shpenzimeve për bllokim apo zhvendosje të automjetit.
3. Operatori është i obliguar të kthejë shumën e paguar në rastet kur pronari apo shfrytëzuesi i automjetit, për rastin përkatës shpallet i pafajshëm në procedure për kundërvajtje.

### Neni 16

1. Automjeti i zhvendosur i cili nuk merret në afatin prej 6 (gjashtë) muajve, për të cilin është i informuar pronari në mënyrë të rregullt, mbi bazën e vlerësimit të ekspertit gjyqësor caktohet vlera e automjetit dhe kur shpenzimet e zhvendosjes dhe ruajtjes e tejkalon shumën e vlerësuar të automjetit, Komuna dhe operatori e kanë të drejtën e shitjes së automjetit përkatës përmes ankandit publik.
2. Komuna nuk merr kurrfarë obligimi për pagesë të qëndrimit të automjeteve në parkun e operatorit ekonomik në përjashtim të ndihmës administrative më rastin e ankandit të publikuar bashkërisht.
3. Shpenzimet e vlerësimit të ekspertit gjyqësor, sipas paragrafit paraprak, konsiderohen shpenzime të zhvendosjes dhe ruajtjes së automjetit.

### Neni 17

1. Për automjetin e braktisur i cili zhvendoset në lokacionin e operatorit, shpenzimet i bartë pronari apo shfrytëzuesi i fundit të automjetit sipas të dhënave të Ministrisë së punëve të brendshme, përkatësisht të Qendrës së regjistrimit të automjeteve.

2. Në rastet kur automjeti nuk merret në afatin prej 6 (gjashtë) muajve iniciohet dhe zhvillohet procedura sipas kushteve të parapara në nenin paraprak të kësaj Rregulloreje.
3. Policia ka obligim ndaj Komunës respektivisht ndaj Drejtorisë Për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, që të raportoji për çdo 6 (gjashtë) muaji lidhur me numrin e automjeteve të bllokuara dhe të zhvendosura, për arsye të përcjelljes së gjendjes financiare të automjeteve që kompania ka obligime financiare ndaj Komunës sipas Marrëveshjes valide të determinuar mes Kompanisë dhe komunës pas zgjidhjes së kompanisë sipas procedurave të prokurimit.

## Neni 18

### Tarifat për bllokimin dhe zhvendosjen e automjeteve

1. Për automjetin I cili bllokohet apo zhvendoset, tarifat janë si vijon:
  - 1.1. Bllokimi I automjetit brenda qytetit.....20 €;
  - 1.2. Zhvendosja e automjetit brenda qytetit..... 30 €;
  - 1.3. Zhvendosja e kombinuesve dhe xhipeve.....40 €;
  - 1.4. Bllokimi I kamionit dhe autobusit brenda qytetit..... 30 €;
  - 1.5. Zhvendosja e Kamionit dhe autobusit brenda qytetit.....70 €;
  - 1.6. Për bllokim dhe zhvendosje të automjetit nga zonat jashtë qytetit, përveç tarifës përkatëse, është edhe tarifa shtesë,
  - 1.7. Në vajtje.....0.25 €, për km;
  - 1.8. Në kthim.....0.50€, për km;
  - 1.9. Në rast se pronari apo shfrytëzuesi I automjetit, kërkon lirimin e automjetit para se të arrijë automjeti për transferim.....15€;
  - 1.10. Në rast se automjeti I zhvendosur nuk tërhiqet në afat prej 48 orëve për çdo 24 orë paguhet tarifa.....8€.

## Neni 19

1. Fletë pagesa për lirimin e automjetit të bllokuar apo të zhvendosur, përveç shumës së paguar përmban të dhënat për:
  - 1.1. Markën dhe tipin e automjetit;
  - 1.2. Numrin e tagrave;
  - 1.3. Emrin, mbiemrin dhe numrin e letërnjoftimit të pronarit apo shfrytëzuesit;
  - 1.4. Datën e bllokimit apo zhvendosjes dhe datën e lirit të automjetit.

## Neni 20

## Zbatimi i Rregullores

1. Drejtoria e Shërbimeve Publike, Emergjente, është përgjegjëse për mbikëqyrjen, menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punëve në përmbushjen e obligimeve të operatorit konform dispozitave të kësaj Rregullore, Policia e Kosovës dhe inspektorati kompetent.
2. Drejtoria e cekur në këtë nen, në funksion të mbarëvajtjes së punëve mund të nxjerr udhëzime përkatëse të cilat janë të obliguara për operatorin.
3. Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, ka obligim që të përcjell anën financiare të kompanisë në bazë të LMFPF.

### Neni 21

Për të gjitha çështjet tjera, të cilat nuk janë paraparë më këtë Rregullore, do të zbatohen dispozitat tjera ligjore të cilat janë në fuqi dhe të cilat vijnë nga niveli Qendror.

### Neni 22

1. Përgjegjësia dhe të drejtat e Komunës dhe operatorit, më afërsisht caktohen me kontratë të veçantë, pas procedurave ligjore të prokurimit.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 dite pas publikimit në ueb faqen e Komunës së Klinës.

## KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr 052-5227 /2018.  
Klinë, dt. 02 / 08 /2018

